Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Rinisë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 18 datë 24/ 10/ 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lënda: **Për miratimin e hartës së linjave sipas largësive për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km (të ndryshuar), në institucionet arsimore parauniversitare të Bashkisë Has.**

I. BAZA LIGJORE Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Rinisë, në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 03.06.2020, "Për transportin e nxënësve dhe të mësuesve në institucionet arsimore publike";
- Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 02.07.2020, si dhe në përputhje me kompetencat e Këshillit Bashkiak për miratimin e politikave vendore në fushën e arsimit, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit dhe Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Has.

II. OBJEKT I SHQYRTIMIT Objekti i shqyrtimit të këtij raporti është miratimi i hartës së linjave të transportit për punonjësit arsimorë dhe nxënësit që udhëtojnë mbi 2 kilometra nga vendbanimi në institucionin arsimor përkatës, në kuadër të vitit shkollor 2025–2026.

Materiali paraqet linjat ekzistuese dhe ndryshimet e propozuara, bazuar në:

- ndryshimet demografike dhe shpërndarjen e popullsisë në zonat rurale;
- funksionimin e institucioneve arsimore (shkolla 9-vjeçare dhe të mesme);
- nevojat reale të transportit për nxënësit dhe punonjësit arsimorë;
- verifikimet në terren nga specialistët e Bashkisë Has dhe Zyra Arsimore Rajonale Kukës.

IV. DISKUTIMI DHE VLERËSIMI Gjatë mbledhjes së Komisionit:

U kerkua rishikimi i linjave, pasi përmirëson shërbimin e transportit dhe siguron akses të barabartë në arsim për nxënësit e zonave të thella;

U theksua rëndësia e sigurisë në transport dhe respektimit të standardeve të kontraktimit të operatorëve;

Komisioni kërkoi që Bashkia të sigurojë monitorim periodik të performancës së transportit dhe raportim të përvitshëm për çdo ndryshim në nevojat reale të nxënësve.

Pas shqyrtimit të materialit të paraqitur dhe diskutimit të argumentuar të anëtarëve, Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Rinisë, me votim unanim:

VENDOSI:

T'i propozojë Këshillit Bashkiak Has miratimin e:

Hartës së linjave sipas largësive për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km (të ndryshuar), për vitin shkollor 2025–2026;

Të ngarkohet ZVA dhe Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë Has për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi;

Ky raport t'i bashkëlidhet materialit përfundimtar që i paraqitet Këshillit Bashkiak për miratim në mbledhjen e radhës.

KRYETARI I KOMISIONIT

Arminda Karaçoli

SEKRETARI

Shkelqim Myzyraj

Figivi Morina